

VENDIM
Nr.161, datë 18.3.2004

**PËR MËNYRËN E LLOGARITJES, TË CAKTIMIT DHE PAGESËS SË PËRFITIMEVE
PËR PUNONJËSIT, QË KANË PUNUAR NË DISA NDËRMARRJE TË INDUSTRIË
USHTARAKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 10 e 11 të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit, që kanë punuar në ndërmarrjet e industrisë ushtarake, që përfitojnë trajtim të veçantë, më poshtë do të quhen "personi i interesuar", të dorëzojnë pranë drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore, në vendbanimin e tyre, këto dokumente:

- a) Kërkesën për përfitim (përfshirë dhe deklarimin nëse ushtron ose jo veprimtari ekonomike);
- b) Certifikatën e lindjes, me fotografi;
- c) Librezën e punës;

ç) Vërtetimin nga organet e tatim-taksave, se nuk ushtron veprimtari ekonomike, si person fizik ose juridik.

Personi i interesuar paraqet një kopje të kërkesës për përfitim edhe në administratën e ndërmarrjes ku ka qenë vendi i fundit i punës së tij.

2. Administrata e ndërmarrjes së industrisë ushtarake, që ka qenë vendi i fundit i punës së të interesuarit, pasi shqyrton kërkesën, plotëson këto dokumente:

a) Vërtetimin për vjetërsinë në punë, ku përfshihen periudhat e sigurimit të punës në ndërmarrjet e industrisë ushtarake dhe të gatishmërisë;

b) Vërtetimin e bazës së vlerësuar, për të cilën është derdhur kontributi i sigurimeve shoqërore, nga viti 1994 deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

Këto dokumente i dërgohen Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën regjistrimin e dokumentacionit të mësipërm dhe ua dërgon drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore, ku është paraqitur kërkesa e personit të interesuar për kryerjen e procedurave të përfitimit dhe të pagesës së tij.

4. Masa e përfitimit minimal, kur mungojnë dokumentet për llogaritjen e bazës së vlerësuar për përcaktimin e përfitimit, të jetë 6728 (gjashtëmijë e shtatëqind e njëzet e tetë) lekë.

5. Efektet financiare për këtë vit fillojnë nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 dhe arrijnë shumën 162 000 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy milionë) lekë, e cila ndahet në zërat, si më poshtë vijon:

a) "Paga" në shumën 108 000 000 (njëqind e tetë milionë) lekë të përballohet nga buxheti i vitit 2004, zëri "Pagesë papunësie", i miratuar për Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.

b) "Kontributet e sigurimeve shoqërore", në shumën 54 000 000 (pesëdhjetë e katër milionë) lekë, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

6. Për periudhën 1 janar 2004 deri në çastin e hyrjes në fuqi të ligjit, personat e interesuar të trajtohen me pagesë papunësie.

7. Punonjësit e tjerë, që nuk përfitojnë sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004, të trajtohen me pagë për periudhën 1 janar 2004 deri më 31 dhjetor 2004, si më poshtë vijon:

a) Sipas vendimit nr.389, datë 8.8.2002 të Këshillit të Ministrave, gjithsej 10 punonjës të uzinës mekanike, Gramsh.

b) Sipas vendimit nr.766, datë 8.12.1998 të Këshillit të Ministrave "Për pagesën e punonjësve të disa linjave teknologjike, ushtarake, të rëndësisë së veçantë", të ndryshuar:

- 311 punonjës të kombinatit mekanik, Polican;

- 19 punonjës të uzinës mekanike, Gramsh;
- 20 punonjës të uzinës së lëndëve plasëse, Elbasan;
- 5 punonjës të uzinës së riparimit të aviacionit, Kuçovë;
- 20 punonjës të uzinës së pilave, Gramsh.

8. Efektet financiare, në zbatim të pikës 7 në shumën 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekë, të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2004, zëri “Pagesë papunësie”, miratuar për Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.

9. Dhënia e përfitimit të bëhet sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale.

10. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale, Ministri i Financave dhe Drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano